



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**LISTA E PËRKOHËSHME NË PAJTUESHMËRI ME NENIN 64.2 TË URDHËRESËS
ADMINISTRATIVE 2006/17**

NSH. "METALOGRAFIKA" NË GJILAN

**LISTA E PËRKOHËSHME E PUNËTORËVE TË CILËT I KANË PLOTËSUAR KUSHTET PËR
MARRJEN E NJË PJESE TË TË ARDHURAVE NGA SHITJA PREJ PRIVATIZIMIT TË N.SH-së
"METALOGRAFIKA" NË GJILAN**

Pas privatizimit/likuidimit të NSH-së "Metalografika" (Reklam Kosovo Fi. 196/77) në Gjilan, e regjistruar në Gjykatën Ekonomike me nr. Fi 901/89 ('NSH-ja'), neni 64.2 i Urdhëresës Administrative 2006/17 kërkon që lista e përkohëshme e personave që konsiderohet se i kanë plotësuar kushtet sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 (me ndryshime) për marrjen e pjesës prej 20% nga privatizimi/shitja e aseteve në likuidim të NSH.

Personat në vijim me përvojën e tyre të punës në NSH konsiderohen se i kanë plotësuar kushtet për marrjen e pjesës prej 20% të të ardhurave nga shitja:

Emini	Enver	24.76	Ahmeti	Ismajl	28.10	Ramadani	Imer	27.96
Hamdiu	Hamdi	21.39	Goga	Basri	27.43	Shala	Izet	27.85
Ademi	Isa	22.76	Ademi	Bashkim	6.59	Lipovica	Rexhep	26.84
Krosa	Halit	17.00	Berisha	Qamil	27.85			

Sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, një punëtor ka të drejtë në pjesën prej 20% nga çmimi i shitjes nëse ai/ajo është i evidentuar si punëtor në atë NSH në kohën e privatizimit/likuidimit dhe që ka qenë në listën e pagave të NSH-së për jo më pak se tri vite. Një punëtor që nuk e përmbush këtë kriter prapë mund të kualifikohet nëse konstatohet se diskualifikimi i tij/saj është bërë në baza të diskriminimit.

Personi i cili konsideron se duhet të jetë në listë ose që dëshiron ta kundërshtojë një apo më shumë emra të cilët gjinden në listën e publikuar duhet të dorëzojnë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) formularin në vijim si dhe dëshmi mbështetëse të cilat i ka në dispozicion ashtu siç është përcaktuar me posht:

Emri i NSH-së		NSH. "METALOGRAFIKA" NË GJILAN	
Emri i Parashtruesit të ankesës			
INFORMATAT E KËRKUARA NË LIDHJE ME ANKESAT			
Ankesa ti bashkëngjitet listës së punëtorëve		Informata të bashkëngjitura?	
1	Kopja e librezës së punës apo ndonjë dëshmi tjetër që konfirmon punësimin tënd në NSH . Te gjitha fotokopjet e dokumentacionit tuaj duhet të jantë të vërtetuara nga organi kompetent	Po/Jo	
2	Shënimet tuaja personale ku mund të ju kontaktojmë;	Po/Jo	
3	A konsideroni se keni pësuar për shkak të diskriminimit (nëse është i aplikueshem)	Po/Jo	
4	Ndonjë dëshmi tjetër që e konsideroni të nevojshme për ankesën tuaj.	Po/Jo	
Kundërshtimi i ndonjë emri-emrave të cilet janë aktualisht në listë			
5	Bazat mbi të cilat ju e kundërshtoni përfshirjen e një apo më shumë	Po/Jo	

	emrave në listë – nëse ka më shumë se një emër atëherë duhet të specifikohet secili emër dhe arsyeja(et) për atë kundërshtim, se bashku me dëshmi relevante për secilin rast.	
6	Bazat mbi të cilat ju e kundërshtoni përvojën e punës të paraqitur si dhe dëshmitë që e mbështesin atë.	Po/Jo
Nënshkrimi i parashtruesit të ankesës		Data

Nëse ankesa parashtrohet në emër të parashtruesit të ankesës nga pala e tretë (p.sh avokati) atëherë pala e tretë duhet të prezantoj dëshmi me shkrim se është i autorizuar për të vepruar në emrin e tij/saj.

TË GJITHA ANKESAT NË LIDHJE ME KËTË NJOFTIM DUHET TË DORËZOHEN NË AKM DERI ME DATEN 8 QERSHOR 2009 PARA PËRFUNDIMIT TË ORARIT TË PUNËS

Adresa për shërbime për të gjithë parashtruesit e ankesave është Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) Rr. Ilir Konushevc nr.8, Prishtinë, Kosovë.

Tel: ++381 38 500 400 ext 0. Fax-i: ++ 381 38 248 076 Posta elektronike: info@pak-ks.org

AKP do të shqyrtoj të gjitha ankesat e dorëzuara në afatin e parapar në pajtueshmëri me këtë njoftim. AKP mund të kërkoj informata shtesë ose të organizoj seanca dëgjimore të dëshmive, pas të cilave lista përfundimtare e punëtorëve të kualifikueshëm do të publikohet në pajtueshmëri me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13.